



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E premte, 18 mars 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 10.3.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-2991 (422), datë 8.7.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 2957
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 13, datë 10.3.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2015-447, datë 24.2.2015 të Gjykatës së Lartë; nr. 468, datë 22.6.2012, të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 3125, datë 20.12.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë..... 2961
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 10.3.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm..... 2964
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 10.3.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2013-1275 (187), datë 7.3.2013, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 2971
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 10.3.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të: - vendimeve nr. 9405, datë 9.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 2029, datë 6.10.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe nr. 462, datë 1.12.2011 dhe nr. 1736, datë 4.7.2014, të Gjykatës së Lartë, të marra gjatë procesit gjyqësor me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi”; - vendimeve nr. 7497, datë 1.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 395, datë 16.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, të marra gjatë procesit gjyqësor me objekt “Rivendosje në posedim”;

- vendimeve nr. 1504, datë 4.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 120, datë 20.1.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, të marra gjatë procesit gjyqësor me objekt “Kundërshtim veprimi përmbartimor”;
- vendimeve nr. 1585, datë 26.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe nr. 1326, datë 8.6.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të marra gjatë procesit administrativ me objekt “Detyrimi i Këshillit të Ministrave të ekzekutojë vendimin nr. 76, datë 8.11.2000, të Gjykatës Kushtetuese”;
- nenit 16 të ligjit nr. 9719, datë 23.4.2007, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”;
- aktit normativ nr. 3, datë 1.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar” dhe ligjit nr. 82/2012, datë 13.9.2012, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”.
- Shpërblimi i dëmit jashtëkontrator material dhe moral në shumën 30 900 000 lekë, i shkaktuar nga veprimet antikushtetuese të administratës shtetërore, dhe fitimi i munguar në shumën 21 356 400 lekë, për kohën nga momenti i nxjerrjes me dhunë nga shtëpia në vitin 2011 deri në dorëzimin e saj, bazuar në nenin 44 të Kushtetutës.
- Detyrimi i Gjykatës Kushtetuese për të ekzekutuar vendimin e saj nr. 76, datë 8.11.2000.
- Detyrimi i shtetit shqiptar që nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese të privatizojë banesë falas për kërkuesit.
- Arkivimi i një kopjeje të procesit në dosjet personale të funksionarëve që kanë shkaktuar paligjshmërinë në bashkëpunim dhe në shpërdorim të detyrës, në shkelje të Kushtetutës.
- Garantimi i jetës së kërkuesve nga dhunuesit, persekutuesit dhe shpërdoruesit e pushtetit, në kuptim të nenit 21 të Kushtetutës.
- Botimi në gazeta i një kopjeje të praktikës gjyqësore.....



VENDIM
Nr. 12, datë 10.3.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 11.12.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 70/24 Akti, që i përket:

KËRKUES: Petref Halili

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Inspektorati i Ndërtimit Urbanistik Vlorë, Bashkia Vlorë, Këshilli i Rregullimit të Territorit Bashkia Vlorë, ALUIZN-i, qarku Vlorë, Avokatura e Shtetit.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2014-2991 (422), datë 8.7.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Bashkisë së Vlorës dhe ALUIZNI-it Drejtoria e Vlorës, të cilat janë shprehur për rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

1. Kërkuari Petref Halili, si punëtor i ish-ndërmarrjes bujqësore “Rinia”, Vlorë, është pajisur me tokë bujqësore në përdorim, e ndodhur në qytetin e Vlorës. Mbi këtë sipërfaqe toke në vitin 1992, pa leje nga organet kompetente, kërkuari ka ndërtuar një lokal shërbimesh. Për këtë objekt kërkuari ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e tij, kërkesë që është pranuar nga ALUIZNI dhe janë realizuar procedurat e kalimit të pronësisë. Mbi këtë bazë kërkuari është bërë pronar i pasurisë me sipërfaqe trualli 500 m² dhe sipërfaqe ndërtimore të objektit njëkatësh 260 m².

2. Në vitin 2008 subjekti i interesuar, Bashkia Vlorë, ka nxjerrë në favor të shtetasve E.T. dhe A.B. lejen e sheshit të ndërtimit, si dhe ka pajisur me leje ndërtimi një shoqëri ndërtimore. Këto akte përfshijnë edhe sipërfaqen e tokës dhe objektin që posedonte kërkuari Petref Halili sipas aktit të marrjes së tokës në përdorim dhe që në atë kohë ishte në proces legalizimi. Në vitin 2009, Inspektorati Urbanistik Vendor i Bashkisë Vlorë ka urdhëruar dhe realizuar prishjen e objektit njëkatësh të ndërtuar nga kërkuari. Për pasojë, kërkuari i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor në shumën 12.000.000 lekë, në bazë të nenit 608 të Kodit Civil.

3. Me vendimin nr. 758, datë 1.4.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e INU-së Bashkia Vlorë që të dëmshpërblejë kërkuarin në shumën 17.717.818 lekë.

4. Me vendimin nr. 182, datë 9.11.2010, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Bashkia Vlorë.

5. Me vendimin nr. 00-2014-2991 (422), datë 8.7.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur: “*Prishjen e vendimit nr. 182, datë 9.11.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr. 758, datë 1.4.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*”.

6. Pas kthimit të çështjes për rishqyrtim, me kërkesën e datës 28.1.2015, kërkuari ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi, pasi vendimet janë



ekzekutuar dhe ai i ka marrë dëmshpërblimet. Për pasojë, me vendimin nr. 107, datë 30.1.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

II

7. **Kërkuesi Petref Halili** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën e datës 3.7.2015, për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-2991 (422), datë 8.7.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke argumentuar:

7.1 Është cenuar e drejta e njoftimit, bazuar në nenin 61/3 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Kërkuesi nuk është njoftuar për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë as 21 ditë para shqyrtimit të rekursit, as në një moment tjetër.

7.2 Gjykata e Lartë duhej të kishte vendosur mospranimin e rekursit. Ajo nuk ka të drejtë ta shqyrtojë çështjen kryesisht përderisa nuk ka një recurs që ta vërë atë në lëvizje. Heqja dorë nga recursi nga pala e paditur në proces është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 490 të KPC-së para se të niste shqyrtimi i kësaj çështjeje në seancë gjyqësore dhe është nënshkruar nga vetë titullari i Bashkisë Vlorë.

7.3 Është cenuar e drejta e disponimit të palëve, pasi gjykata nuk mund të dalë tej vullnetit të palëve.

7.4 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi vendimi kishte marrë formë të prerë. Edhe pse ishte hequr dorë nga recursi, Gjykata e Lartë e ka cenuar këtë vendim duke sjellë pasoja shumë të rënda për kërkuesin.

8. **Subjekti i interesuar, Bashkia e Vlorës**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës është shprehur si vijon:

8.1 Administrata aktuale e Bashkisë së Vlorës nuk mund të arsyetojë rrethanat mbi bazën e të cilave është paraqitur recursi dhe më pas është hequr dorë prej tij. Kjo për shkak të ndryshimeve në administratë si rezultat i reformës administrativo-territoriale, si dhe të zgjedhjeve të fundit për organet e qeverisjes vendore.

8.2 Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk cenon as sigurinë juridike, as të drejtat dhe liritë themelore të individit. Ky vendim është rrjedhojë logjike e

vijimit të procedurave gjyqësore, bazuar në dispozitat e KPC-së për të drejtën e ankimit dhe të rekursit.

8.3 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar rekursin dhe ka marrë vendimin përkatës, pasi, siç rezultoi, heqja dorë nga recursi është bërë më vonë, ndërkohë që në seancën gjyqësore nuk është paraqitur përfaqësuesi i Bashkisë për ta konfirmuar atë.

8.4 Kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës. Çështja është duke u gjykuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe do të zgjidhet duke eliminuar mangësitë procedurale të pretenduara nga palët.

9. **Subjekti i interesuar, ALUIZNI, Drejtorja e Vlorës**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës është shprehur si vijon:

9.1 Kërkuesi ka aplikuar për legalizimin e një objekti informal, i cili në vitin 2009 është prishur. Në këto kushte ai nuk është objekt i punës së ALUIZNI-t.

9.2 Konkluzioni i gjykatave të faktit se kërkuesi ishte pronar nuk qëndron, pasi në bazë të VKM-së nr. 438/2006, miratimi i kalimit të pronësisë në favor të aplikuesit nuk do të thotë domosdoshmërisht se ky objekt do të pajiset me leje legalizimi.

9.3 Për shkak të mbetjes “e pakonfirmuar” të vërtetësisë së zhvillimit të seancës në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe veprimeve të kryera në të, si dhe për shkak të mosnënshkrimit të procesverbalit të seancës gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, jemi dakord me vendimin e dhënë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë



veprimtarinë e saj, legjitimitimi i individit për t'iu drejtuar kësaj Gjykate përbën një nga parakushtet procedurale për ta vënë atë në lëvizje. Në kuptim të neneve 131/f dhe 134/2 të Kushtetutës, ai mund t'i drejtohet Gjykatës për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si edhe nëse plotëson kriterin kushtetues të “detyrimit për të justifikuar interesin”, i cili është përcaktues i ndarjes së rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori, subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Individit, si një nga subjektet e kushtëzuara, ka legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tij (*shih vendimin nr. 59, datë 23.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individit ka detyrimin të provojë se në ç'mënyrë ai është prekur në të drejtat e tij kushtetuese si pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Interesi i tij për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak, dhe ai duhet të konsistojë tek e drejta e shkelur dhe te dëmi real i shkaktuar.

12. Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, Gjykata vëren se me vendimin nr. 00-2014-2991 (422), datë 8.7.2014 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 758, datë 1.4.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe të vendimit nr. 182, datë 9.11.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Me kërkesën e datës 28.1.2015 kërkuesi ka hequr dorë nga gjykimi, për arsye se vendimet janë ekzekutuar. Për pasojë me vendimin nr. 107, datë 30.1.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, vendim i cili ka marrë formë të prerë.

13. Sipas nenit 201 të KPC-së paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë dhe në këtë rast gjykata vendos pushimin e gjykimit, kurse sipas nenit 299 të KPC-së, gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ... b) paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë.... Pushimi i gjykimit, sipas nenit 300 të KPC-së, sjell anulimin e të gjitha veprimeve procedurale, duke përfshirë edhe vendimet që jepen gjatë gjykimit.

14. Bazuar në rrethanat e çështjes konkrete, si edhe në detyrimin që sipas nenit 134, pika 1/g dhe pika 2 të Kushtetutës palët kanë për të provuar interesin, Gjykata vlerëson se në kushtet

kur kërkuesi ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes, gjë që ka sjellë për pasojë pushimin e gjykimit, atij tashmë i mungon interesi për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, dhe kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuess Petref Halili jemi kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, ndaj në vijim do të paraqesim argumentet tona si gjyqtarë në pakicë.

2. Gjykata ka theksuar se në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, individit mund t'i drejtohet asaj për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individit përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'iu jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).



3. Neni 13 i KEDNJ-së parashikon se “*çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura nga kjo Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare edhe atëherë kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare*”. E drejta për ankim efektiv është një e drejtë themelore e njeriut dhe nënkupton të drejtën e individit për ankim, ekzistencën e një organi të caktuar për shqyrtimin e ankimit, pranimin e pakushtëzuar të ankimit për shqyrtim, afate të arsyeshme për shqyrtimin e tij, shqyrtimin objektiv, kontrollin gjyqësor, si kontroll përfundimtar ndaj ankimit, si dhe mundësinë e rehabilitimit të mundshëm si pasojë e pranimit eventual të ankimit. Që një “zgjdhje të jetë efektive” Konventa kërkon që ajo t’i lejojë organet e brendshme kompetente të merren si me thelbin e ankesës përkatëse lidhur me shkeljen e një të drejte të Konventës, dhe me dhënien e dëmshpërblimit të përshtatshëm. Një zgjidhje është efektive vetëm nëse ajo është e disponueshme dhe e mjaftueshme. Ajo duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë dhe duhet të jetë efektive si në praktikë dhe në ligj, duke marrë parasysh rrethanat individuale të çështjes (*shih El-Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, vendim i datës 13 dhjetor 2012; Kudla kundër Polonisë, vendim i datës 26 tetor 2000.*) Ankimi individual në Gjykatën Kushtetuese është një nga mjetet juridike që ofron sot kuadri kushtetues dhe ligjor shqiptar në dispozicion të individit për mbrojtjen e të drejtave të tij të shkelura nga një proces i parregullt ligjor.

4. Nga rrethanat e çështjes konkrete rezulton se me vendimin nr. 00-2014-2991 (422), datë 8.7.2014 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 758, datë 1.4.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe të vendimit nr. 182, datë 9.11.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Pas dhënies së këtij vendimi kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur tej kompetencave të tij, pasi ka pranuar për shqyrtim një rekurs nga i cili ishte hequr dorë më parë, për rrjedhojë vendimi i tij është jokushtetues. Pas paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese,

kërkuesi ka paraqitur edhe kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë, në të cilën do të fillonte shqyrtimi i çështjes pas kthimit të saj nga Gjykata e Lartë. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, e cila, me vendimin nr. 107, datë 30.1.2015, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

5. Fakti i heqjes dorë nga gjykimi i çështjes është përdorur si argument nga shumica për rrëzimin e kërkesës, e cila ka arsyetuar “*në kushtet kur kërkuesi ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes, gjë që ka sjellë për pasojë pushimin e gjykimit, atij tashmë i mungon interesi për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës dhe kërkesa duhet të rrëzohet.*” (*shih paragrafin 14 të vendimit*).

6. Në ndryshim nga shumica ne vlerësojmë se kërkuesi jo vetëm legjitimohet për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues, por edhe se kërkesa në thelb është e bazuar dhe duhej të pranohet. Legjitimin e kërkuesit ne e shohim në dy aspekte, në atë të shterimit të mjeteve ligjore dhe të provimit të interesit të tij.

7. Për sa i takon shterimit të mjeteve të ankimit, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, edhe pse në raste të tilla, të kthimit të çështjes për rishqyrtim nga Gjykata e Lartë, Gjykata ka vlerësuar se nuk jemi përpara një vendimi përfundimtar, i cili të ketë vendosur në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes, rasti në shqyrtim paraqet specifikë, pasi shkeljet e kryera në Gjykatën e Lartë janë të tilla që nuk mund të riparohen në shkallët e tjera të gjykimit. Në kushtet kur Gjykata e Lartë ka shqyrtuar një rekurs nga i cili ishte hequr dorë nga pala rekursuese, duke vepruar në kundërshtim me rregullimet e neneve 480 dhe 490 të KPC-së, ajo ka dalë tej kompetencave të saj ligjore. Në rast se kërkuesit do t’i kërkohej përfundimi i procesit në të tria shkallët e gjykimit, pas kthimit të çështjes për rigjykim, atëherë pretendimet e tij do të binin në dekadencë dhe nuk do të merreshin dot më në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese. Po ashtu i gjithë ky proces që do të zhvillohej do të ishte jokushtetues, për sa kohë që vetë vendimi i Gjykatës së Lartë që e ka kthyer çështjen për rigjykim nuk plotëson kërkesat për një proces të rregullt. Siç është theksuar në jurisprudencën kushtetuese, e drejta për një proces të rregullt



ligjor nuk mund t'i cenohet palëve në proces për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore. Në këtë kuptim, kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është mjeti efektiv për kërkesin për rivendosjen e së drejtës ë cenuar.

8. Për sa i takon interesit të kërkesit për të vënë në lëvizje Gjykatën, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, sërish vlerësojmë se fakti që ai ka hequr dorë nga gjykimi nuk mund të përdoret si argument për rrëzimin e kërkesës. Edhe pse sipas neneve 201 dhe 299 të KPC-së heqja dorë nga gjykimi passjell pushimin e tij, këto dispozita nuk janë relevante për gjykimin kushtetues. Për sa kohë që shkeljet e kryera nga Gjykata e Lartë janë të tilla që e bëjnë të parregullt atë proces, të gjitha vendimet që do të merreshin pas këtij vendimi do të ishin, gjithashtu, jokushtetuese dhe nuk do të sillnin pasoja për palët në gjykim. Fakti që kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesën në shqyrtim, provon tërësisht interesin e tij në këtë çështje. Duke vendosur rrëzimin e kërkesës, shumica ka legjitimuar një vendimmarrje jokushtetuese të gjykatave të zakonshme, duke i mohuar kërkesit të gjithë mbrojtjen kushtetuese për të rivendosur të drejtën e tij të cenuar të pronësisë nëpërmjet një procesi jo të rregullt ligjor. Me vendimet gjyqësore të shkallës së parë dhe të apelit kërkuesi kishte realizuar të drejtën e tij, kishte tërhequr paratë e dëmshpërblimit, pra vendimet e prishura nga Gjykata e Lartë kishin sjellë pasoja për të, për rrjedhojë rigjykimi (e më pas pushimi i çështjes) do të thotë se kërkuesi duhet të kthejë dëmshpërblimin e fituar me vendimet gjyqësore. Ky fakt përforcon edhe më shumë interesin e kërkesit për shqyrtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë nga Gjykata Kushtetuese, pasi ky vendim ka sjellë pasoja në të drejtat e tij dhe gjykimi kushtetues është mjeti efektiv për rivendosjen e së drejtës.

9. Për të gjitha argumentet e mësipërme, ne gjyqarët në pakicë vlerësojmë se kërkuesi legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe se Gjykata duhej të vendoste pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-2991 (422), datë 8.7.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili duke marrë në shqyrtim një rekurs nga i cili ishte hequr dorë, ka cenuar parimin e gjykatës së

caktuar me ligj, si një nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj

VENDIM
Nr. 13, datë 10.3.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 26.1.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 73/27 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjergji Grazhdani

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Vasil Kovaçi, Fredi Mullamake, Fehim Pasho, Fatos Pajo

OBJEKTI: Shfuqizimi si të pajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 00-2015-447, datë 24.2.2015, të Gjykatës së Lartë; nr. 468, datë 22.6.2012, të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 3125, datë 20.12.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 28 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

1. Kërkuesi është banor i qytetit të Bilishtit dhe fqinjë me subjektet e interesuara; me padi drejtuar gjykatës kërkuesi ka kërkuar detyrimin e subjekteve të interesuara t'i lirojnë dhe dorëzojnë atij një sipërfaqe trualli, me pretendimin se ata e posedojnë në mënyrë të paligjshme.

2. Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 3125, datë 20.12.2004 ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

3. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 85, datë 14.4.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit *supra* të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

4. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 1194, datë 26.10.2006, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Korçë dhe kthimin e akteve për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 145, datë 12.4.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3125, datë 20.12.2004, të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 60, datë 10.2.2011, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 145, datë 12.4.2007, të Gjykatës së Apelit Korçë, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

7. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 468, datë 22.6.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3125, datë 20.12.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

8. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2015-447, datë 24.2.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

9. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

9.1 *Është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se nuk është vënë në dijeni për saktësimin e vendimit nga Gjykata e Apelit

Korçë dhe kjo çështje sipas tij duhej të trajtohej nga Gjykata e Lartë.

9.2 *Është cenuar e drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi proceset gjyqësore kanë zgjatur rreth 11 vjet.

9.3 *Është shkelur e drejta e pronës*, pasi gjykatat i kanë mohuar kërkuesit të drejtën për të poseduar pronën e tij si pronar i ligjshëm.

9.4 *Gjykata e Shkallës së Parë dhe e ajo e Apelit Korçë, nuk kanë zbatuar drejt ligjin dhe udhëzimet e Gjykatës së Lartë*, pasi kjo çështje është kthyer për rigjykim, çka përbën shkelje të parimit të gjyqimit të drejtë dhe të paanshëm.

10. **Subjektet e interesuara** Vasil Kovaçi, Fredi Mullamake, Fehim Pasho dhe Fatos Pajo kanë parashtruar:

10.1 Kërkuesi ka investuar gjykatat në të gjitha shkallët, duke abuzuar me të drejtën për të ngritur padi dhe në mashtrim të ligjit, pasi ka fshehur dokumentet të cilat vërtetonin pronësinë e sipërfaqes prej 36.4 m² në emër të subjekteve të interesuara.

10.2 Pretendimet për shkelje procedurale nga ana e Gjykatës së Apelit Korçë nuk qëndrojnë, pasi vendimmarrja e saj bazohet jo vetëm në aktin e ekspertimit, por edhe në këqyrjen e objektit konflikt gjykimi si dhe në një sërë provash shkresore.

10.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i ka marrë në analizë pretendimet e kërkuesit, duke i vlerësuar si të bazuara në ligj.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se pretendimet kryesore të ngritura nga kërkuesi, të cilat bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,



janë cenimi i standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe cenimi i së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

13. Sipas kërkesit është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili nuk ka vlerësuar shkaqet e rekursit dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në të.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 49, datë 10.7.2015; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, arsytimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 49 datë 10.7.2015; nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 108, datë 3.10.2012; nr. 17, datë 17.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret vendimi i mospranimit të rekursit përmban, në pjesën hyrëse të tij, objektin e padisë, disponimet e gjykatave, si dhe shkaqet që kërkesi ka parashtruar në rekurs. Ndërsa në pjesën arsyetuese, në përputhje me

standardet e gjykimit paraprak në dhomën e këshillimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, pasi nuk përmban asnjërin prej rasteve që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, duke vendosur në pjesën urdhëruese mospranimin e tij.

17. Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se pretendimi i kërkesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm

18. Kërkesi ka pretenduar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në shkelje të nenit 42/2 të Kushtetutës.

19. Sipas nenit 42 të Kushtetutës kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 12, datë 5.3.2012; nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata vëren se ka një kohëzgjatje të konsiderueshme të proceseve gjyqësore të cilat kanë nisur në vitin 2004 dhe kanë vazhduar për rreth 11 vjet. Çështja ka kaluar disa herë në të gjitha nivelet e gjykimit të juridiksionit të zakonshëm përfshirë edhe gjykimin në Gjykatën e Lartë i cili ka zgjatur për rreth tre vjet, por kërkesi nuk ka sjellë argumente që të provojnë shkeljen e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë kuptim, kërkesi nuk ka arritur të shpjegojë se në ç'mënyrë ka ndikuar sjellja e autoriteteve gjyqësore përkatëse në administrimin në tërësi të procesit. Si rrjedhim, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkesit duhet rrëzuar si i pabazuar.

D. Në lidhje me pretendimet e tjera



21. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat i kanë mohuar të drejtën për të poseduar pronën e tij si pronar i ligjshëm. Sipas tij, Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit Korçë nuk kanë zbatuar drejt ligjin dhe udhëzimet e Gjykatës së Lartë, pasi kjo çështje është kthyer për rigjykim, çka përbën shkelje të parimit të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm.

22. Referuar natyrës ligjore të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata konstaton paraprakisht se pretendimet e kërkuesit i takojnë juridiksionit të zakonshëm dhe jo kategorisë së çështjeve që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson qëndrimet e mbajtura në vendimmarrjet e saj të mëparshme se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, dhe si të tilla nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 31, datë 5.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit lidhur me cenimin e së drejtës së pronës janë të pabazuara.

24. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “F”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të

Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 14, datë 10.3.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 10.11.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 52/11 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Sokol Hasani

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

1. Kërkuesi Sokol Hasani është ndaluar nga Policia Rrugore në datën 4.4.2014 dhe pas verifikimit të dokumentacionit të mjetit nga punonjësi i policisë është vendosur tërheqja e lejes së drejtimit dhe e lejes së qarkullimit.

2. Me pretendimin se kjo masë është në kundërshtim me dispozitat ligjore, kërkuesi në datën 7.4.2014 i është drejtuar gjykatës me padi kundër ministrit të Brendshëm, me objekt detyrimin për ta dëmshpërblyer atë në vlerën e përcaktuar nga gjykata, kthimin e dokumentacionit të automjetit dhe anulimin e masës administrative.

3. Me vendimin nr. 7098, datë 19.6.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur të shpallë moskompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë.

4. Me vendimin nr. 00-2014-2230 (59), datë 22.7.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 7098, datë 19.6.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Pas dërgimit të dosjes gjyqësore në gjykatën kompetente ka filluar shqyrtimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Nga Gjykata e Lartë dosja është dërguar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në datën 25.9.2014, ndërsa me fletëhirrjen e datës 8.4.2015 kërkuesi është njoftuar për seancën e datës 23.4.2015 pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

II

6. **Kërkuesi Sokol Hasani** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë në datën 5.6.2015, duke pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Sipas tij nuk janë respektuar afatet e zhvillimit të gjykimit, që bie në kundërshtim me nenin 25 e vijues të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili ka përcaktuar afatet kohore deri në dhënien e vendimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës individit legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme. Kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm mund të merren në shqyrtim pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se sistemi juridik i vendit nuk parashikon ndonjë mjet juridik të veçantë të cilin mund ta përdorte kërkuesi për të kërkuar riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit gjyqësor. Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga GJEDNJ-ja në vendimin e datës 23.10.2007 “Gjonboçari kundër Shqipërisë”, §.77, në të cilin është shprehur se sistemi juridik shqiptar nuk parashikonte një mjet të veçantë juridik të cilin kërkuesi mund ta kishte përdorur për riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit. Të njëjtën gjë GJEDNJ-ja e ka konstatuar edhe në vendimin “Marini kundër Shqipërisë” të datës 7.7.2008, §.154, si dhe në vendimin “Hamzaraj kundër Shqipërisë” të datës 3.2.2009, §.30. Në këtë kuptim, edhe kërkuesi Sokol Hasani legjitimohet për paraqitjen e kësaj kërkesë.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm

8. Kërkuesi pretendon se është cenuar në të drejtën për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes së tij gjyqësore brenda afateve ligjore, të cilat vetë ligji i ka parashikuar të jenë të shpejta e të arsyeshme.

9. Sipas nenit 42 të Kushtetutës kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë vendos detyrimin



për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjyqimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata pretendimet e kërkuarit lidhur me tejzgjatjen e gjyqimit i shqyrton nën dritën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, të reflektuara edhe në praktikën e saj, pra referuar rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje.

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

11. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhen me periudhën që prej datës 25.9.2014, kur dosja është dërguar nga gjykata e lartë në gjykatën administrative, e në vijim. sipas tij zgjatja e gjyqimit tej afatit të arsyeshëm ka ardhur si rrjedhojë e moszbatimit të dispozitave të ligjit nr. 49/2012.

ii) Kompleksiteti i çështjes

12. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative (detyrimi i palës së paditur për të dëmshpërblyer palën paditëse, anulimi i sanksionit administrativ të vendosur në mënyrë të paligjshme etj.), gjykimi i së cilës parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjyqimit të mosmarrëveshjeve administrative”. Nga shqyrtimi i akteve të

paraqitura Gjykata vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuarit është me rëndësi në këtë kontekst.

iii) Interesi dhe sjellja e kërkuarit

14. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës Gjykata vëren se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjyqimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv) Sjellja e autoriteteve

15. Gjykata, ndër të tjera, është shprehur se në këndvështrim të respektimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor gjykatat kanë për detyrë të evitojnë çdo vonesë të panevojshme në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, rezulton se padia është paraqitur nga kërkuari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve në gjykatën administrative si gjykata kompetente. Ky vendim është ankimuar nga kërkuari në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin e datës 22.7.2014, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës civile të shkallës së parë.

17. Me kërkesën e datës 30.3.2015 kërkuari ka kërkuar informacion në lidhje me dosjen gjyqësore pranë Gjykatës së Lartë dhe asaj të shkallës së parë. Me shkresën e datës 8.4.2015, kancelari i Gjykatës së Lartë i ka kthyer përgjigje se dosja është dërguar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në datën 25.9.2014.

18. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë çështja rezulton të jetë regjistruar në datën 3.4.2015 dhe me shortin e datës 7.4.2015, ajo i është caktuar gjyqtarës E.V. Nga procesverbal i datës 8.4.2015 për kryerjen e veprimeve përgatitore nga gjyqtari rezulton se seanca e radhës është caktuar në datën 23.4.2015, për të cilën kërkuari është njoftuar me fletëthirrjen e po asaj date. Kjo seancë nuk është zhvilluar, pasi gjyqtarja relatores ishte me raport shëndetësor.



19. Me fletëthirjen e datës 23.4.2015, kërkuesi është njoftuar për seancën përgatitore të datës 7.5.2015. Kjo seancë për kryerjen e veprimeve përgatitore është zhvilluar me praninë e palëve ndërgjyqëse dhe seanca e radhës është caktuar në datën 18.5.2015 për përcaktimin e vlerës së dëmit nga pala paditëse dhe paraqitjen e disa akteve të noterizuara nga palët. Në seancën e veprimeve përgatitore të datës 18.5.2015, po në prani të palëve, gjykata ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, e cila është caktuar të zhvillohet në datën 28.5.2015.

20. Me shkresën nr. 1501/1 prot., datë 18.5.2015 të KLD-së, gjyqtarja relatoje E.V. është shkëputur nga detyra për periudhën 20.5.2015–20.7.2015 dhe dosjet që ka pasur në gjykim janë rihedhur në short. Çështja me paditës kërkuesin Sokol Hasani rezultoi t'i jetë caktuar gjyqtarit A.S., çka del edhe nga regjistri elektronik i veprimeve të kryera nga sekretaria e gjykatës, si edhe nga fletëthirja e datës 29.5.2015, me anë të së cilës kërkuesi është njoftuar për seancën e datës 9.7.2015.

21. Gjykata vëren se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 ka përcaktuar, ndër parimet e gjykimit administrativ, edhe sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësimit në krijimin e këtyre gjykatave, çka rezultoi edhe nga relacioni bashkëlidhur tij, sipas të cilit ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, si dhe garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjykata vëren, gjithashtu, se ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate konkrete për gjykimin në të tria shkallët e gjykimit. Për sa i takon procesit që zhvillohet në shkallë të parë, në fazën e veprimeve përgatitore ligji ka parashikuar një afat 7-ditor për kryerjen e disa veprimeve nga ana e gjyqtarit të çështjes (neni 25), afatin për zhvillimin e seancës gjyqësore, i cili nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë (neni 27), si edhe afatin 7-ditor për dorëzimin e dosjes pas shpalljes së vendimit (neni 42).

22. Për sa më sipër, Gjykata thekson se përderisa ligjvënësi ka vendosur afate kohore të caktuara (30 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se

ai i ka konsideruar ato jo vetëm si afate të arsyeshme, por edhe të detyrueshme për zbatim nga gjykatat administrative të të gjitha shkallëve të gjykimit. Pengesat e mundshme objektive duhet të gjejnë zgjidhje nëpërmjet rregullimit që duhet të bëjë ligjvënësi.

23. Mosrespektimi i këtyre afateve ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, duke sjellë mosgjykimin e çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuesi brenda një afati të arsyeshëm, ka cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor.

24. Gjykata në rastin konkret nuk konstaton arsye objektive të cilat do të justifikojnë mosgjykimin brenda afateve ligjore. Për rrjedhojë Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda një afati të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

1. Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) ka pranuar pretendimin e kërkuesit Sokol Hasani për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, pasi nuk janë respektuar afatet e



zhvillimit të gjykimit të përcaktuara në ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

2. Pavarësisht konkluzionit të shumicës, nuk pajtohem me këtë qëndrim për faktin se vendimi i Gjykatës është deklarativ dhe nuk përbën një mjet efektiv ankimi, pasi nuk sjell asnjë efekt për ecurinë e procesit, për sa kohë çështja është mbyllur në juridiksionin administrativ.

3. Gjykata, në vështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, lidhur me interpretimin e nenit 13 të KEDNJ-së, i cili sanksionon termin “ankim efektiv”, ka theksuar se është e rëndësishme të përcaktohet se çfarë mjetes, sipas rastit, janë në dispozicion të individit dhe nëse ato i krijojnë atij mundësi reale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë efektive. Në këtë drejtim është evidentuar se një ndër kriteret që duhet të plotësojë një ankim për të qenë efektiv është që mjeti të ofrojë mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Ajo ka përcaktuar, gjithashtu, se mjeti që të jetë efektiv, duhet të jetë i përshtatshëm, i disponueshëm dhe efikas për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 9, datë 15.3.2013; nr. 27, datë 20.6.2007; nr. 6, datë 31.3.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në jurisprudencën e saj GJEDNJ-ja e ka trajtuar çështjen e efektivitetit të mjetit të ankimit në një perspektivë më të gjerë, duke dhënë disa orientime lidhur me karakteristikat që duhet të ketë një mjet i brendshëm ankimi. GJEDNJ-ja ka konstatuar se mjeti më i mirë i ankimit, si në çdo fushë tjetër, është pa dyshim parandalimi. Ajo ka mbajtur në mënyrë të përsëritur qëndrimin se neni 6/1 imponon mbi shtetet kontraktuese detyrimin për t’i organizuar sistemet e tyre gjyqësore në atë mënyrë që gjykatat e tyre të mund të përmbushin secilën nga kërkesat e tij, veçanërisht për sa i përket afatit të arsyeshëm (*shih, ndër të tjera, Süßmann kundër Gjermanisë nr. 20024/92, prg. 55*). Kur sistemi gjyqësor ka mangësi në këtë drejtim, një mjet i projektuar për të përshpejtuar procedurat, me qëllim parandalimin e kohëzgjatjes së tepërt të procesit, përbën zgjidhjen më efektive. Një mjet i tillë ofron një avantazh të pamohueshëm në raport me një mjet i cili parashikon vetëm kompensimin, sepse jo vetëm eviton konstatimin

e shkeljeve të njëpasnjëshme për të njëjtën procedurë, por nuk kufizohet vetëm në veprimin *a posteriori*, siç ndodh në rastin e një mjeti ankimi për kompensim (shembulli italian). GJEDNJ-ja në shumë raste i ka njohur këtij lloji ankimi një karakter efektiv në masën që ai lejon përshpejtimin e vendimit gjyqësor në fjalë (*shih ndër të tjera Luli kundër Shqipërisë, nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09 Scordino kundër Italisë nr. 36813/97 prg. 184, Bacchini kundër Zvicrës nr. 62915/00, Tomé Mota kundër Portugalisë nr. 32082/96*).

5. GJEDNJ-ja mendon se masat e përgjithshme në nivel kombëtar janë pa dyshim të nevojshme gjatë zbatimit të vendimit aktual (*Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë*), duke përfshirë, veçanërisht, prezantimin e një kompensimi vendas për kohëzgjatjen e papërshtatshme të procedurave. Në këtë vendim GJEDNJ-ja u referohet konkluzioneve të saj në çështjen Scordino, cituar më sipër, për sa u përket elementeve të kërkuara për një kompensim efektiv për kohëzgjatjen e tepruar të procedurave, duke ritheksuar se mjeti më i mirë i ankimit, si në çdo fushë tjetër, është pa dyshim parandalimi. Në shumë raste, GJEDNJ-ja e ka pranuar se kjo lloji zgjidhje është “efikase”, duke qenë se ajo përshpejton vendimin e gjykatës përkatëse.

6. Gjithashtu, është e qartë se për vende ku shkeljet e procedurave të tejzgjatura ende ekzistojnë, një zgjidhje e cila mund të përshpejtojë procedurat – edhe pse e dëshirueshme për t’u pasur në të ardhmen – mund të mos jetë e përshtatshme për të rregulluar një situatë në të cilën procedurat tashmë kanë qenë dukshëm jashtëzakonisht të gjata.

7. Zgjidhje të ndryshme mund ta rregullojnë situatën e një shkeljeje në mënyrën e duhur. GJEDNJ-ja tashmë e ka pranuar këtë gjë në lidhje me procedurat penale, ku sigurohet se kohëzgjatja e procedurave është marrë në konsideratë gjatë uljes së dënimit, në formë të shprehur dhe në masë gjithashtu. Për më tepër, disa shtete, si: Austria, Kroacia, Spanja, Polonia dhe Sllovakia, e kanë kuptuar shumë mirë situatën, duke zgjedhur të kombinojnë dy lloje zgjidhjesh, njëra e hartuar në mënyrë të tillë që mund të përshpejtojë procedurat dhe tjetra që të



përballojë kompensimin. Megjithatë, shtetet mund të zgjedhin dhe të prezantojnë vetëm një zgjidhje kompensuese, siç ka bërë Italia. Një zgjidhje e tillë nuk shikohet si jofikase (*shih, për më gjerë, Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë*).

8. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme çmoj se shumica duhej ta rrezonte kërkesën, për sa kohë konstatimi i shkeljes së nenit 6/1 të Konventës efektivisht nuk sjell një rezultat konkret për kërkuuesin në drejtim të rivendosjes të së drejtës së tij të shkelur. Sipas qëndrimit tim, shumica duhet ta zgjeronte analizën në drejtim të nenit 13 të Konventës dhe të vlerësonte efektivitetin e këtyre lloj ankimeve në Gjykatën Kushtetuese, duke reflektuar në vendimmarrje orientimet e GJEDNJ-së. Vendime të tilla kanë thjesht natyrë deklarative dhe formale dhe nuk riparojnë në thelb shkeljen e pretenduar. Ato vetëm konstatojnë shkeljen dhe e deklarojnë atë, por nuk rregullojnë pasojat e ardhura prej saj dhe as nuk i njohin individit, ndaj të cilit konstatohet shkelja, dëmshpërblim, siç parashikohet në sisteme të tjera ligjore (rasti i Italisë).

Anëtar: Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuues Sokol Hasanin, ashtu siç jam shprehur edhe më parë në vendimin nr. 35, datë 17.7.2013, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes administrative brenda një afati të arsyeshëm.

2. Shumica ka vlerësuar se kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, mund të merren në shqyrtim, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*paragrafi 7*). Në vijim, shumica, pasi ka vlerësuar kriteret që lidhen me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuessit dhe të autoriteteve gjyqësore, ka arritur në përfundimin se gjykimi i kësaj çështjeje është tejzgjatur për shkak të mosmarrjes së masave të

nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3. Shterimi i mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkon që individi të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara. Kushti paraprak i shterimit të mjeteve juridike duhet të përmbushet nga kërkuuesi përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por dhe të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që kërkuuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 15, datë 18.4.2007; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 36, datë 10.11.2010; nr. 17, datë 16.5.2011; nr. 42, datë 25.6.2015*).

4. Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata Kushtetuese nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre. Mbi këtë bazë, bëhen objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Rregulli i shterimit të mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese e gjykimit në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (parimi i subsidiaritetit) (*shih vendimin nr. 23, datë 4.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Kërkuuesi duhet të provojë para Gjykatës, në aspektin e shterimit të mjeteve, se nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara apo edhe se shqyrtimi gjyqësor nuk mund t'i ndreqë këto shkelje. Në rrethana të tilla, është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të



vlerësojë, sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkuesi i ka shteruar ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara.

6. Në kuptim të sa më sipër përsëris qëndrimin se kërkuesi nuk duhej të ishte legjitimuar për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kushtet kur çështja administrative e iniciuar prej tij është ende në shqyrtim në sistemin gjyqësor dhe nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga gjykata administrative.

7. Qëndrimi i shumicës lë të kuptosh se i njëjti individ mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese disa herë brenda të njëjtit proces gjyqësor, veçmas për çdo pretendim për zvarritje të procesit gjyqësor, në çdo shkallë të tij (edhe gjatë gjyqimit të çështjes në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë) dhe më pas, pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe dhënies së një vendimi përfundimtar, edhe për pretendime të tjera që lidhen me të njëjtin proces gjyqësor.

8. Ashtu siç jam shprehur edhe më parë, qëllimi i nenit 131/f të Kushtetutës, i cili përcakton rregullin e shterimit të mjeteve juridike, është të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese. Në rastin konkret, shumica nuk ka verifikuar se cilat janë garancitë procedurale me të cilat janë të pajisura palët gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse këto mjete konsiderohen ligjore, të njohura nga ligji, të mjaftueshme, të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete dhe nëse kërkuesi i ka shteruar mjete të tilla. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se individët gëzojnë të gjitha garancitë procedurale nga sistemi ligjor për rivendosjen në vend të të drejtave të tyre para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Pretendimet që kërkuesi ka ngritur para Gjykatës Kushtetuese nuk janë të tilla që t'i shmangen kontrollit të mëtejshëm gjyqësor, pasi një pretendim i tillë mund të paraqitet lirisht jo vetëm para gjykatës që shqyrton çështjen, por mund të parashtrohet më tej në gjykatat më të larta si shkak për apel apo për rekurs. Po ashtu, rendi ligjor ka parashikuar për palët në proces edhe mjete të tjera ligjore që u japin mundësinë atyre që në raste të tilla të

kërkojnë qoftë përjashtimin e gjyqtarit, në rast se ai është shkak për vonesat në gjykim, qoftë t'i drejtohen KLD-së me ankesë për të. Këto mjete konsiderohen ligjore, të njohura nga ligji, të mjaftueshme, të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete.

9. Qëndrimi i mbajtur nga shumica në çështjen konkrete mendoj se nuk përmbush kërkesat për ta konsideruar vendimin në fjalë si mjet efektiv, i cili i ofron mundësi të qarta dhe të sigurtat kërkuesit për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, në kuptim të nenit 13 të Konventës, *mjetet* në dispozicion të një ndërgjyqësi për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit janë “efektive”, në qoftë se ato “*parandalojnë shkeljen e pretenduar, pengojnë vazhdimin e saj ose ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur*”. Siç shprehet GJEDNJ-ja, neni 13 i KEDNJ-së ofron një alternativë: një mjet është “efektiv” në qoftë se mund të përdoret për të përshpejtuar dhënien e një vendimi nga gjykatat që gjykojnë një çështje ose për t'i ofruar ndërgjyqësit një riparim të përshtatshëm për vonesat që tashmë kanë ndodhur. Megjithatë, thekson GJEDNJ-ja, zgjidhja më e mirë është padyshim, parandalimi. Kur një sistem gjyqësor ka mangësi për sa i përket kërkesës në nenin 6/1 të Konventës – për një afat të arsyeshem - një mjet i dizenuar për të përshpejtuar procesin, me qëllim parandalimin e bërjes së këtij procesi të tejzgjatur, është zgjidhja më efektive. Një mjet i tillë ofron një avantazh të pamohueshem në krahasim me një mjet që ofron vetëm kompensim, përderisa ai parandalon, gjithashtu, shkeljet e mëpasshme për të njëjtat procese dhe jo thjesht riparon shkeljen *a posteriori*, siç bën një mjet kompensues. Disa shtete kanë zgjedhur kombinimin e dy lloj mjeteve, njëri i dizenuar për të përshpejtuar procesin dhe tjetri për të ofruar kompensim (*shih Scordino kundër Italisë, nr. 1, aplikimi nr. 36813/97, § 183 dhe, 186, i cituar në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë, aplikimi nr. 10508/02, §§ 75 e 76*).

10. Në mënyrë që procedura e ankimit individual kushtetues të përbëjë zgjidhje efektive, në kuptimin e nenit 13 të KEDNJ-së, ajo duhet të japë edhe dëmshpërblim efektiv për shkeljen. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese, parë në



këndvështrim krahasues me kuadrin ligjor të vendeve të tjera, duhet të jetë e pajisur me kompetencën për urdhërimin e pagimit të kompensimit dhe/ose urdhërimin e *restitutio in integrum* (shembulli i Austrisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe Sllovakisë).

11. Shumica ka arsyetuar se “përderisa ligjvënësi ka vendosur afate kohore të caktuara (30 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato jo vetëm si afate të arsyeshme, por edhe të detyrueshme për zbatim nga gjykatat administrative të të gjitha shkallëve të gjyqimit. Pengesat e mundshme objektive duhet të gjejnë zgjidhje nëpërmjet rregullimit që duhet të bëjë ligjvënësi?” (shih § 22 të vendimit).

12. Këtë qëndrim të shumicës e vlerësoj formalist, pasi mendoj se nuk është me vend të vendosësh barazinë midis konceptit “afat i arsyeshëm” dhe “afat ligjor”. Është e kuptueshme dhe e natyrshme që ligjvënësi në përcaktimin ligjor të afateve kohore të detyrueshme për zbatim gjatë proceseve gjyqësore, të vlerësojë si kriter të rëndësishëm arsyeshmërinë, në kuptimin që afati ligjor duhet të mos jetë i konceptuar në mënyrë ekstreme. Palët e interesuara duhet të kenë mundësi ta respektojnë atë afat pa sforcime të skajshme, në rast se është shumë i shkurtër, ndërsa nëse është konceptuar shumë i gjatë, atëherë ai ngre dyshime serioze për cenimin e sigurisë juridike në gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore.

13. Në kontekstin e çështjes në fjalë arsyeshmëria e afatit duhet parë *lato sensu* dhe jo *stricto sensu*. Edhe GJEDNJ-ja ka përpunuar disa kriteret, mes të cilave edhe “*periudhën që duhet të merret në konsideratë*”, dhe nuk e ka lidhur arsyeshmërinë e afatit brenda të cilit gjykohet një çështje domosdoshmërisht me afatin ligjor (ditë apo muaj), por e vlerëson çështjen në dritën edhe të rrethanave të tjera.

14. Në vështrim të sa më sipër mendoj se qëndrimi i shumicës është një vlerësim i nxituar dhe i shkëputur tërësisht nga realiteti kompleks i organizimit dhe funksionit të gjyqësorit administrativ. Ky vlerësim nuk nënkupton në asnjë rast që sistemi ligjor vendas nuk duhet të jenë në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, sepse kjo është një domosdoshmëri jetike. Misioni i Gjykatës Kushtetuese, krahas sigurimit të njëtrajtshmërisë të jurisprudençës kushtetuese për sa i takon vlerësimin të faktorëve

që (nuk)garantojnë standardet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, është edhe konstitucionalizimi i gjyqësorit të zakonshëm dhe nxitja e dialogut me të, në kuptimin që përmes vendimeve të saj Gjykata Kushtetuese e orienton atë drejt zhvillimit të proceseve gjyqësore që ofrojnë garanci procedurale dhe materiale për palët ndërgjyqëse. Madje për të shkuar edhe më tej, Gjykata Kushtetuese mund të orientojë edhe politikën ligjvënëse përmes jurisprudençës së saj.

15. Megjithatë ritheksoj se vendimet Gjykata Kushtetuese, para së gjithash, duhet të jenë një mjet efektiv për garantimin e të drejtave dhe lirive që pretendohen se janë shkelur. Në këtë kuptim, vlerësimi i shumicës nuk duhet të krijojë pritshmëri të gabuara dhe jo realiste për kërkuesin, pasi një vendim i natyrës thelbësisht deklarative jo vetëm nuk e përshpejton procesin, por as përbën mundësi dëmshpërblimi të drejtë për të.

16. Në përfundim mendoj se konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e shumicës është një përfundim i parakohshëm, për faktin se Gjykata Kushtetuese ka mundësi ta shqyrtojë këtë pretendim bashkë me vendimin përfundimtar për zgjidhjen në themel të çështjes.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 15, datë 10.3.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 24.11.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 38/4 Akti që i përket:

KËRKUES: Sazan Tefa

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë, Avokatura e Shtetit



OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2013-1275 (187), datë 7.3.2013, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 28 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që kërkoji pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarisi është trashëgimtar ligjor i radhës së parë i trashëgimlënësit L.T. (babai i tij), fakt i cili provohet nga dëshmia e trashëgimisë nr. 371, datë 14.5.1993. Me vendimin nr. 1905, datë 5.11.1993, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, me objekt vërtetimit fakti pronësie, ai është njohur si pronar mbi tri troje të ndodhura në Radhim.

2. Në vitin 2005 kërkuarisi i është drejtuar Zyres Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për të rivendosur të drejtat e pronësisë mbi tri pasuritë e mësipërme. Kërkesa është pranuar nga Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e cila, me vendimin nr. 7, datë 16.12.2005, ka vendosur t'i njohë kërkuarisi të drejtën e pronësisë me kufizimet përkatëse edhe mbi sipërfaqen prej 10 800 m², të ndodhur në vendin e quajtur “Rrethi i Mullirit” në fshatin Radhim, Vlorë, si dhe ta kompensojë për këtë sipërfaqe sipas përcaktimeve të nenit 11, të ligjit nr. 9395, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

3. Kërkuarisi i është drejtuar Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për ndryshimin e pjesës së vendimit të mësipërm për sa i takon pjesës së kompensimit, kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr. 153, datë 5.7.2006 të Komitetit Shtetëror, i cili vendosi shfuqizimin e të gjithë Faqe|2972

vendimit dhe kthimin për rishqyrtim pranë KKKP-së Vlorë.

4. Me pas kërkuarisi i është drejtuar Zyres Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Vlorë me kërkesë për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi një sipërfaqe prej 10 800 m², e ndodhur në Radhim, Vlorë, si dhe kthimin e saj në natyrë. Zyra Rajonale e Qarkut Vlorë fillimisht ka refuzuar të shprehet lidhur me këtë kërkesë, por e ka marrë atë në shqyrtim pasi dhënies së vendimit nr. 777, datë 26.3.2008 nga Gjykata së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e vënë në lëvizje nga kërkuarisi.

5. Me vendimin nr. 222, datë 25.6.2008, Zyra Rajonale ka vendosur të mos ia njohë të drejtën e pronësisë kërkuarisi, i cili për këtë shkak ka paraqitur ankim pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 1155, datë 29.10.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Zyres Rajonale.

6. Pas shterimit të ankimit administrativ, kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi me objekt anulimin e vendimeve të mësipërme. Gjykata, me vendimin nr. 2052, datë 30.7.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se provat e administruara në gjykim nuk provuan të drejtën e pronësisë së kërkuarisi dhe se vetëm vendimi gjyqësor i vërtetimit të faktit të pronësisë, i pashoqëruar me prova të tjera, nuk mund të shërbejë për njohjen dhe kthimin e pronës së pretenduar.

7. Kundër vendimit të mësipërm kërkuarisi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 966, datë 19.11.2010, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 2052, datë 30.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt: pranimin e kërkesëpadisë; ndryshimin e vendimit nr. 1155, datë 29.10.2008 të AKKP-së dhe të vendimit nr. 222, datë 25.6.2008 të ZRKKP-së, qarku Vlorë: të njohë të drejtën e pronësisë së trashëgimlënësit (trashëgimtarëve të tij) dhe të kthejë në natyrë sipërfaqen e tokës prej 10 800 m², të ndodhur në fshatin Radhim, Vlorë, me kushtet përkatës ...”.

8. AKKP-ja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për pezullimin e vendimit nr. 966, datë 19.11.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe rekurs, kurse kërkuarisi ka paraqitur kundërrekurs.



Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 162, datë 27.4.2010, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë. Në lidhje me rekursin, pasi e ka marrë atë në shqyrtim në seancë gjyqësore, me vendimin nr. 00-2013-1275 (187), datë 7.3.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 966, datë 19.11.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2052, datë 30.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me arsyetimin, midis të tjerash, se “...paditësi, ndryshe nga sa ka arritur në përfundim Gjykata e Apelit Vlorë, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të paraqitjes së provave bindëse për të provuar pretendimet e tij”.

II

9. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 23.3.2015 me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

9.1 Është cenuar *parimi i barazisë së armëve* dhe kontradiktoritetit në funksion të *së drejtës së mbrojtjes* në procesin civil.

9.2 Është cenuar *parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë i ka rivlerësuar provat në të kundërt me analizën e Gjykatës së Apelit Vlorë, madje edhe i ka keqinterpretuar disa nga faktet, si dëshminë e pasurisë së H.P. të vitit 1942. Po ashtu, nuk përmend në vendim përgjigjen nr. 7/5, datë 25.2.2009, të Arkivit të Ministrisë së Mbrojtjes ku shkruhet se L.T. në asnjë rast nuk ka qenë përfitues nga reforma agrare e viti 1946. Të gjitha këto parregullsi kanë çuar në arritjen e konkluzioneve të gabuara nga Kolegji Civil.

9.3 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim pretendimin mbi pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 153, datë 5.7.2006, të AKKP-së, të marrë në përfundim të procesit të shqyrtimit kryesisht të vendimit nr. 7, datë 16.12.2005, të KKKP-së. Edhe pse në seancë u pretendua se vendimi i AKKP-së bie ndesh me vendimin nr. 27, datë 20.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji Civil nuk e analizoi këtë pretendim.

9.4 AKKP-ja nuk mbështet në prova pretendimet e parashtruara në rekurs që lidhem më faktet që kërkuesi nuk është subjekt i ligjit nr. 9235/2004, që ai nuk provon pronësinë para vitit

1944 dhe shpronësimin pa të drejtë, që nuk ekziston në listën e pronarëve të viteve 1950–1952, që harta shoqëruese e vendimit nuk plotëson kushtet formale, që dokumentacioni tekniko-ligjor nuk është në përputhje me kriteret ligjore të VKM-së nr. 747, datë 9.11.2006.

9.5 Prona është njohur me vendimin e AKKP-së, i cili është kundërshtuar pjesërisht vetëm për sa i takon moskthimit në natyrë të truallit që është i lirë. Pronësia provohet edhe nga dokumentacioni i dalë nga Arkivi i Shtetit, si dhe nga ekstraktet e hartës së ushtrisë italiane të viti 1942 të arkivit të Fushë-Krujës, si dhe nga harta treguese me indeks K-34-123- (256B), 2K-3140 e ZVRPP-së, Vlorë të administruara në procesin gjyqësor.

10. *Subjekti i interesuar, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave*, ka prapësuar me shkrim si vijon:

10.1 Gjykata e Lartë ka vendosur drejt, në zbatim të ligjit material dhe procedural, duke siguruar një proces të rregullt për palët pjesëmarrëse në procesin gjyqësor civil.

10.2 Nga dokumentacioni i dosjes nuk provohet se kërkuesi (trashëgimlënësi i tij) të ketë pasur në pronësi pronën e pretenduar, të jetë shpronësuar nga shteti apo prona t'i jetë marrë në mënyrë të paligjshme.

10.3 Prona e pretenduar nga kërkuesi në vendin e quajtur “Rrethi i Mullirit” nuk ka lidhje me pronën e përshkruar në dëshminë e pasurisë për pronat e shtetasit H.P. hartuar nga kryeplaku i fshatit Dukat në vitin 1942.

10.4 Po ashtu, edhe pse prona e ndodhur në vendin e quajtur “Hunda e Rizit” i është njohur e kthyer kërkuetit me vendimin nr. 5, datë 16.12.2005 të KKKP-së Vlorë dhe është regjistruar në favor të trashëgimlënësve të L.T., kufijtë e saj nuk përkojnë me pronën e pretenduar.

10.5 Nga listat emërore të pagimit të taksave të banorëve të fshatit Radhim rezulton se prona për të cilën është paguar taksa është ajo e njohur si “Rrethi i Mullirit”, që ka qenë tokë zhavorrishte, pa fryt.

10.6 Edhe vërtetimi kadastral i datës 23.6.1993, lëshuar nga SAMT-ja Sarandë nuk provon se kërkuesi ka qenë pronar, pasi është regjistrim i kryer në zbatim të ligjit nr. 108/1945, “Për reformën agrare”, për rrjedhojë bie ndesh



me përcaktimet e ligjit nr. 9235/2004, i ndryshuar, dispozitat e të cilit nuk zbatohen për pronat e përfituara si rezultat i ligjit nr. 108/1945.

10.7 Gjithashtu, vendimi për vërtetimin e faktit juridik nuk provon pronësinë e kërkuarit mbi pronën e pretenduar, për arsye se s'mund të shërbejë si provë.

11 *Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit*, në prapësimet e depozituara me shkrim prapëson si vijon:

11.1 Pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë është i pabazuar, pasi në seancën gjyqësore publike ai ka qenë i përfaqësuar me avokat, i cili ka parashtruar pretendimet para Kolegjit Civil.

11.2 Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi se Kolegji Civil ka nxjerrë konkluzione të kundërta nga ato të Gjykatës së Apelit Vlorë. Zgjidhja e çështjes është bazuar në të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë, qëndrim i cili përputhet edhe me jurisprudencën kushtetuese në këtë drejtim.

11.3 Vendimi objekt kundërshtimi është i bazuar në ligj dhe në provat e paraqitura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, siç janë: dëshmia e pasurisë për pronat e shtetasit H.P. e vitit 1942, që nuk ka lidhje me pronën e pretenduar nga kërkuari në vendin e quajtur "Rrethi i Mullirit"; dëshmia e pronësisë së H.L., e vitit 1942, që tregon se ai ka në pronësi një bahçe me ullinj që kufizohet në lindje dhe në jug me L.T., në përfundim me shkëmbin e Rizit dhe në veri me përroin; vërtetimi kadastral i datës 23.6.1993, i cili nuk ka të pasqyruar si pronë vendin e quajtur "Rrethi i Mullirit".

11.4 Edhe duke iu referuar bazës ligjore për zgjidhjen e çështjes, konkretisht ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", nenet 2 dhe 6, përcaktojnë se që të jesh subjekt i këtij ligji duhet të provosh të drejtën e pronësisë mbi pronën e pretenduar dhe marrjen e saj pa të drejtë pas datës 29.11.1944. Kërkuari nuk arriti të provojë pronësinë e trashëgimlënësit L.T. mbi sipërfaqen 108000 m² dhe vendimi gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë, i pashoqëruar me prova të tjera, nuk mund të shërbejë për njohjen dhe kompensimin e pronës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit

12. Kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese". Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, pretendimet e parashtruara në kërkesë *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në funksion të së drejtës së mbrojtjes

13. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e mbrojtjes, në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi nuk i ka ofruar mundësi të barabarta me palën tjetër për të organizuar mbrojtjen në gjykim.

14. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural më parë dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës së cenuar, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në



gjykatë (*shih vendimet nr. 31, datë 26.6.2014; nr. 28, datë 22.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen konkrete Gjykata vëren se në kërkesë mungojnë argumente lidhur me faktin se në çfarë mënyre apo mase kërkuesit i është cenuar barazia e armëve dhe e kontradiktoriteti në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

16. Në këtë kuptim Gjykata vlerëson se për sa kohë kërkuesi nuk ka argumentuar pamundësinë efektive në raport me palën tjetër për të paraqitur argumente në mbrojtje të interesave të pretenduara si të cenuara gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit, pretendimi i tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në funksion të së drejtës së mbrojtjes në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

17. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë, në kundërshtim me rastet e përcaktuara në nenin 472 të KPC-së, i ka rivlerësuar provat në të kundërt me analizën e Gjykatës së Apelit Vlorë, madje edhe i ka keqinterpretuar disa nga faktet e çështjes.

18. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 2, datë 22.1.2014; nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së

Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuar nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).



22. Në çështjen në shqyrtim Kolegji Civil ka vendosur prishjen e vendimit nr. 966, datë 19.11.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2052, datë 30.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kolegji Civil ka arsyetuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë “*është i drejtë për faktin se është rrjedhje e analizës së hollësishtme dhe vlerësimit të arsyetuar të çdo prove të administruar në gjykim*”, duke renditur konkretisht edhe provat. Kurse në lidhje me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, Kolegji Civil ka vlerësuar se “*...është marrë në zbatim të gabuar të ligjit, për më tepër ajo gjykatë nuk ka argumentuar përfundimin e saj për ndryshimin e vendimit të shkallës së parë, pasi nuk ka rezultuar që paditësi të ketë pasur në pronësi pronën e pretenduar dhe të jetë shpronësuar nga shteti apo t'i jetë marrë prona në mënyrë të paligjshme...*”.

23. Gjykata vlerëson se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka respektuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes, duke përqendruar vlerësimin në ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimit të kundërshtuar për sa i takon pronësisë mbi sipërfaqen prej 10 800 m², të ndodhur te vendi i quajtur “Rrethi i Mullirit”, në Radhim. Po ashtu, Kolegji Civil ka arsyetuar mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta dhe nuk rezulton të ketë marrë prova të reja apo të ketë bërë një rivlerësim të provave në të kundërt me atë të gjykatave më të ulëta. Në këtë kuptim, Kolegji Civil, duke pranuar të gjitha provat e administruara në gjykatat e faktit dhe pa i ndryshuar, i ka analizuar dhe vlerësuar ato në vështrim të dispozitave ligjore të zbatueshme, duke arritur në përfundimin se Gjykata e Apelit Vlorë ka bërë një interpretim të gabuar të përcaktimeve të ligjit nr. 9235/2008 dhe për këto arsye ka shfuqizuar vendimin e kësaj gjykate.

24. Në këtë kuptim, në çështjen në shqyrtim, Gjykata vlerëson se argumentet e parashtruara nga kërkuesi, në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, janë të pabazuara.

D. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

25. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka cenuar sigurinë juridike, pasi nuk ka analizuar pretendimin e ngritur gjatë gjykimit për pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 153, datë

5.7.2006, të marrë nga AKKP-ja pas shqyrtimit kryesisht të vendimit nr. 7, datë 16.12.2005 të KKKP-së. Sipas kërkuesit, ky vendim bie ndesh me qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese të shprehur në vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës Kushtetuese.

26. Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik (*shih vendimet nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, shqyrton rekurset për pretendime të shkeljes së ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të saj. Ajo analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar. Në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 52, datë 2.12.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Një nga detyrimet që kanë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është edhe zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës, shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë dhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë



fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj (*shih vendimet nr. 17 datë 10.4.2015; nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 5, datë 7.2.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Me vendimin nr. 27, datë 26.5.2010 (*në vijim “vendimi nr. 27/2010”*) Gjykata, e investuar nga Gjykata e Lartë dhe Avokati i Popullit, ka shpallur si të papajtueshme me Kushtetutën kompetencën e drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së për të shqyrtuar kryesisht vendimet e dhëna nga KKKP-ja. Ajo është shprehur në këtë vendim se “kompetenca e drejtorit të AKKP-së për shfuqizimin e vendimeve të ish – KKKP-së, të cilat nuk janë ankimuar brenda afateve ligjore dhe si të tilla kanë marrë formë të prerë, përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, pasi zbatimi nga një organ administrativ si AKKP-ja i parimeve të revokimit dhe shfuqizimit të akteve të ish-KKKP-së, që nuk janë akte tipike administrative të një organi tipik administrativ, konsiderohet si ndërhyrje e pajustifikuar mbi të drejtat civile të shtetasve”.

30. Vendimi nr. 27/2010 është shpallur në datën 26.5.2010 dhe ka hyrë në fuqi në datën 5.7.2010, që është dhe data e botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare nr. 81. Në rastin konkret, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është shpallur në datën 15.2.2010, pra përpara se vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës të hynte në fuqi.

31. Neni 76/b i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” rregullon efektet juridike të vendimeve, duke sanksionuar se vendimet e kësaj Gjykate që kanë shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull, sjellin efekte juridike nga data e hyrjes së tyre në fuqi. Si rregull përjashtimor, vendimi ka fuqi

prapavepruese, ndër të tjera, ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë. Në përputhje me parashikimet e nenit 449 dhe 451 të KPC-së, vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar, në bazë të nenit 479 të KPC-së (*shih vendimet nr. 56, datë 21.12.2012; nr. 16, datë 21.3.2014; nr. 17 datë 10.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata, në referim të rrethanave të çështjes, konstaton se vendimi nr. 153, datë 5.7.2006 i AKKP-së nuk është bërë objekt i ndonjë procesi gjyqësor civil. Nga ana tjetër, kompetenca e drejtorit të AKKP-së për shfuqizimin kryesisht të vendimeve të ish-KKKP-së është deklaruar antikushtetuese me vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka hyrë në fuqi në datën 5.7.2010, pra katër vjet pas marrjes së vendimit të AKKP-së. Në këtë kuptim Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për fuqinë prapavepruese të vendimit nr. 27/2010 të Gjykatës Kushtetuese dhe cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar.

33. Në përfundim Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g”, dhe 133, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha



VENDIM
Nr. 16, datë 10.3.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	nëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 16.12.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 68/22 Akti që i përket:

KËRKUES: Skënder Roqi, Merjeme Roqi, Hasan Roqi, Luljeta Roqi, Santa Roqi, Kevin Roqi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Fatos Kadesha, Hylli Kadesha

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të:

- vendimeve nr. 9405, datë 9.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 2029, datë 6.10.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe nr. 462, datë 1.12.2011 dhe nr. 1736, datë 4.7.2014 të Gjykatës së Lartë, të marra gjatë procesit gjyqësor me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi”;

- vendimeve nr. 7497, datë 1.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 395, datë 16.2.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, të marra gjatë procesit gjyqësor me objekt “Rivendosje në posedim”;

- vendimeve nr. 1504, datë 4.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 120, datë 20.1.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, të marra gjatë procesit gjyqësor me objekt “Kundërshtim veprimi përbarimor”;

- vendimeve nr. 1585, datë 26.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe nr. 1326, datë 8.6.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të marra gjatë procesit administrativ me objekt “Detyrimi i

Këshillit të Ministrave të ekzekutojë vendimin nr. 76, datë 8.11.2000, të Gjykatës Kushtetuese”;

- nenit 16 të ligjit nr. 9719, datë 23.4.2007, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”;

- aktit normativ nr. 3, datë 1.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara” dhe ligjit nr. 82/2012, datë 13.9.2012, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara”.

- Shpërblimi i dëmit jashtëkontrator material dhe moral në shumën 30 900 000 lekë, i shkaktuar nga veprimet antikushtetuese të administratës shtetërore, dhe fitimi i munguar në shumën 21 356 400 lekë, për kohën nga momenti i nxjerrjes me dhunë nga shtëpia në vitin 2011 deri në dorëzimin e saj, bazuar në nenin 44 të Kushtetutës.

- Detyrimi i Gjykatës Kushtetuese për të ekzekutuar vendimin e saj nr. 76, datë 8.11.2000.

- Detyrimi i shtetit shqiptar që nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese të privatizojë banesë falas për kërkuesit.

- Arkivimi i një kopjeje të procesit në dosjet personale të funksionarëve që kanë shkaktuar paligjshmërinë në bashkëpunim dhe në shpërdorim të detyrës, në shkelje të Kushtetutës.

- Garantimi i jetës së kërkuesve nga dhunuesit, persekutuesit dhe shpërdoruesit e pushtetit, në kuptim të nenit 21 të Kushtetutës.

- Botimi në gazeta i një kopjeje të praktikës gjyqësore.

BAZA LIGJORE: Nenet 5, 7, 15/2, 17/2, 18/1, 18/2, 18/3, 21, 25, 37/1, 41/1, 41/2, 42/2, 43, 44, 116/a, 116/c, 116/ç, 117/1, 118/1, 118/2, 131/f, 132/1, 134/1/g, 142/1, 142/3, 145/1 dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 2, 25, 27 e vijues, 30, 36, 37, 40, 41, 42, 50, 81/3 dhe 81/4 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, që kërkuan pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Skënder Roqi nga viti 1989 ka banuar si qiramarrës kryesor në një banesë shtetërore në të cilën, me shpenzimet e veta, ka bërë disa shtesa (korridor, kuzhinë, aneks etj.).

2. Në vitin 1994, Xh.K. është njohur pronar i shtëpisë dhe i shtesave anësore të ndërtuara në oborrin e saj nga kërkuesi me vendimin nr. 314, datë 11.4.1994 e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP-ja), i cili përcaktonte, midis të tjerash, se raporti i vlerës së shtesave me vlerën e plotë të objektit ishte 11.7 %, prandaj prona i kthehej ish-pronarit pa kundërshpërblim, sipas parashikimeve të nenit 3 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave is-pronarëve”.

3. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt anulimin e pjesshëm të vendimit të KKKP-së dhe njohjen e pronësisë mbi shtesat. Gjykata, me vendimin nr. 1666, datë 16.4.1997, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e kërkuësit, me vendimin nr. 2227, datë 8.10.1997 ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm dhe të pikës 2 të vendimit të KKKP-së që kishte të bënte me vlerën e shpenzimeve të kryera nga paditësi, duke njohur 37% baras me vlerën 286 890 lekë kontribut të tij në pjesën që përdor në raport me ndërtesën e ish-pronarit.

5. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 489, datë 26.3.1998 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2227, datë 8.10.1997, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 17, datë 9.2.2000, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësit.

7. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të mësipërme, por ankimi individual

është rrëzuar me vendimin nr. 76, datë 8.11.2000, me argumentin se pretendimet ishin të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese.

8. Në vitin 2007 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2024, datë 20.11.2007, ka vendosur lëshimin e urdhrit për ekzekutimin e vendimit nr. 2227, datë 8.10.1997.

9. Në vitin 2008 kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për falsifikim dokumentesh të pronës nga subjektet e interesuara, por prokuroria, me vendimin e datës 8.5.2008, ka vendosur pushimin e çështjes për mungesë të elementeve të veprës penale.

10. Në vitin 2010 kërkuesi ka marrë pjesë si palë e paditur në procesin gjyqësor civil me objekt “Lirim dhe dorëzim banese” i vënë në lëvizje nga subjektet e interesuara Fatos dhe Hylli Kadesha. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9405, datë 9.12.2010, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesë padisë... Detyrimin e të paditurve Roqi të lirojnë dhe dorëzojnë paditësve ambientet e banimit që posedojnë ...”*. Në pjesën arsyetuese të vendimit thuhet se *“paditësit kanë mbetur bashkëpronarë ekskluzivë të pronës së kthyer me vendim të KKKP-së...ata janë pronarë legjitimë, kurse i padituri nëdorës i paligjshëm...”*.

11. Kundër këtij vendimi kërkuësit kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 2029, datë 6.10.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm. Bazuar në kërkesën e subjekteve të interesuara, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6574, datë 16.11.2011 ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit civil dhe ka urdhëruar zyrën përbarimore ta ekzekutojë atë.

12. Kërkuësit kanë paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të mësipërme dhe Kolegji Civil, me vendimin nr. 462, datë 1.12.2011, ka vendosur mospranimin e kërkesës. Po ashtu, kërkuësit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. 1736, datë 4.7.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit.

13. Kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt “Rivendosje në posedim”, e cila është rrëzuar me vendimin nr. 7497, datë 1.12.2013.

14. Duke pretenduar mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë në procesin e mësipërm, kërkuësit



kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 395, datë 16.2.2015 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

II

15. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 29.6.2015 me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore objekt kundërshtimi, si dhe të disa akteve ligjore e nënligjore, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

15.1 Është cenuar *parimi i paanshmërisë* gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë.

15.1.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka pasqyruar drejt faktet në lidhje me origjinën dhe kufijtë e pronës, por e ka hetuar çështjen në mënyrë të njëanshme. Edhe pse pala e paditur nuk ka bërë vetëm shtesën anësore të ndërtesës, por e ka rikonstruktuar plotësisht atë për shkak të amortizimit, fakt që provohet nga aktekspertiza e viti 1997, gjykata përsëri nuk ka respektuar nenin 139 të Kodit Civil, duke e pranuar si të ligjshme shkeljen e afatit prekluziv njëvjeçar të përcaktuar nga udhëzimi nr. 3, datë 21.6.1993 i KM-së. Gjithashtu, gjatë procesit nuk janë respektuar nenet 192, 196 dhe 197/b të KC-së mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme, duke mbështetur paligjshmërinë e ZRPP-së.

15.1.2 Në shqyrtimin e rekursit në Gjykatën e Lartë ka marrë pjesë i njëjti gjyqtar i cili ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë. Ky gjyqtar ka shqyrtuar më parë edhe kërkesëpadinë me objekt: “Anulimi i vendimit të KKKP-së Tiranë nr. 314, datë 11.4.1994...” dhe me vendimin nr. 2471, datë 19.3.2008 ka vendosur kthimin e kërkesëpadisë dhe të akteve bashkëngjitur, duke e konsideruar atë padi sikur nuk ishte paraqitur më parë.

15.2 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka marrë parasysh faktin që vendimi nr. 2227, datë 8.10.1997, i cili ka marrë formë të prerë, ka njohur investimin në masën 37%. Pavarësisht këtij fakti, Gjykata e Apelit ka përcaktuar vlerën e shpenzimeve pa i caktuar kërkuesve pjesë në pasurinë e paluajtshme, ndërkohë që nuk është shprehur mbi kërkimin për mosrespektimin e ligjit nga ZRPP-ja gjatë regjistrimit të pasurisë në hipotekë vetëm në emër të subjekteve të interesuara. Kjo

parregullsi ka cenuar edhe *të drejtën e pronës* të fituar me vendimin nr. 2227, datë 8.10.1997.

15.3 Gjykata e Apelit Tiranë ka refuzuar kërkesën për pezullimin e gjykimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor me objekt pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 314, datë 11.4.1994, të KKKP-së. Ky qëndrim i gjykatës është i gabuar, pasi kërkuesit të drejtën e pretenduar e kanë zgjidhur me vendimin nr. 2227, datë 8.10.1997, për rrjedhojë gjykata duhet të pushonte gjykimin. Për më tepër, gjykata nuk ka marrë parasysh ligjin nr. 8647, datë 24.7.2000, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, i cili nuk lejonte nxjerrjen nga banesa të qiramarrësve në banesa ish-pronë private me kontratë shtetërore, edhe kur nuk e kishin tagrin e bashkëpronarit.

15.4 Është cenuar *parimi i barazisë së armëve*, sepse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk respektoi parashikimet e neneve 132 e 142 të Kushtetutës dhe të neneve 14 e 28 të KPC-së, pasi mori në konsideratë vetëm certifikatën e pronësisë së palës paditëse dhe nuk hetoi mbi faktet e rrethanat e tjera që lidheshin me atë pronë, nuk shqyrtoi prapësimet e kërkuesve, nuk pranoi kërkesat për pezullimin e procesit për shkak të zhvillimit të një procesi tjetër gjyqësor dhe për krahasimin e të dhënave të vendimit nr. 314/1994 me ato të certifikatës së pronësisë.

15.5 Gjykata e Lartë, gjithashtu, nuk ka respektuar *standardin kushtetues të arsyesimit* të vendimit gjyqësor, pasi nuk arsyetoi mbi shkaqet e mospranimit të rekursit, edhe pse ato janë në përputhje me nenin 472 të KPC-së.

15.6 Gjatë proceseve gjyqësore me objekt “Rivendosje në posedim” dhe “Kundërshtim të veprimeve përmbarimore” nuk është respektuar vendimi nr. 76, datë 8.11.2000, i Gjykatës Kushtetuese.

15.7 Është cenuar *neni 44 i Kushtetutës*, pasi si rezultat i veprimeve të paligjshme të organeve shtetërore kërkuesve u është shkaktuar një dëm i konsiderueshëm moral dhe material, i cili kërkohet të dëmshpërblehet në shumën 30 900 000 lekë dhe fitimi i munguar në shumën 21 356 400 lekë për kohën nga momenti i nxjerrjes me dhunë nga shtëpia në vitin 2011 deri në dorëzimin e saj.

15.8 Neni 16 i ligjit nr. 9719, datë 23.4.2007, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9232,



datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane” u ka cenuar kërkuesve të drejtat e fituara, duke u shkaktuar një dëm të rëndë real për shkak të nxjerrjes me dhunë nga banesa, për rrjedhojë duhet të shfuqizohet.

15.9 Është cenuar *parimi i barazisë para ligjit*, pasi çdo shtetas shqiptar që ka pasur kontratë qiraje me shtetin si ajo e kërkuesit, e ka privatizuar banesën, kurse kërkuesit janë diskriminuar si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë së aktit normativ nr. 3, datë 1.8.2012 të KM-së dhe ligjit nr. 82/2012.

15.10 Është cenuar *e drejta e kërkuesve për të pasur një banesë*, në referim të nenit 37 të Kushtetutës, si rezultat i parashikimeve të aktit normativ nr. 3, datë 1.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara” dhe ligjit nr. 82/2012, datë 13.9.2012, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara”. Këto akte normative përbëjnë shkak për trajtim degradues të kërkuesve, në referim të nenit 25 të Kushtetutës.

16. **Subjektet e interesuara** kanë prapësuar me shkrim si vijon:

16.1 Pretendimi i kërkuesve për regjistrimin e pronës në hipotekë nuk qëndron jo vetëm për faktin se kjo kërkesë i është refuzuar nga ZRPP-ja, por edhe sepse sipas nenit 192 të Kodit Civil regjistrimi kërkohet vetëm për pasuritë e paluajtshme.

16.2 Vendimi i Gjykatës së Apelit ka caktuar vlerën e shpenzimeve që ka kryer paditësi pa përcaktuar pjesë në pasurinë e paluajtshme. Për më tepër, vendimi nuk urdhëron regjistrimin e kësaj pasurie në ZRPP.

16.3 Faktet dhe rrethanat e paraqitura nga kërkuesit janë sa të pavërteta, aq dhe të pabazuara.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuesve

17. Gjykata rithekson se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, individët mund t'i drejtohen kësaj gjykate për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tyre për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet

juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Shterimi i mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkon që individit të shfrytëzohet në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara (*shih vendimet nr. 15, datë 19.4.2013; nr. 36 datë 10.11.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Kushti paraprak i shterimit të mjeteve juridike duhet të përmbushet nga kërkuesi përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata vlerëson të analizojë çështjen e legjitimitimit të kërkuesve për secilin prej kërkimeve të parashtruara prej tyre në objektin e kërkesës.

19. Në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e vendimeve nr. 9405, datë 9.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 2029, datë 6.10.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe nr. 462, datë 1.12.2011 e nr. 1736, datë 4.7.2014, të Gjykatës së Lartë, të marra gjatë procesit gjyqësor me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi”, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës; *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”; *ratione materiae*, pasi pretendimet e parashtruara në kërkesë *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

20. Për sa u takon kërkimeve të kërkuesve për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore nr. 7497, datë 1.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 395, datë 16.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, të marra gjatë procesit gjyqësor me objekt “Rivendosje në posedim”; vendimeve nr. 1504, datë 4.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 120, datë 20.1.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, të marra gjatë procesi gjyqësor me objekt “Kundërshtim veprimi përmbarrimor”; vendimeve nr.



1585, datë 26.3.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 1326, datë 8.6.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të marra gjatë procesit administrativ me objekt “*Detyrimi i KM-së të ekzekutojë vendimin nr. 76, datë 8.11.2000 të Gjykatës Kushtetuese*”, Gjykata vëren se kërkuesit kanë ushtruar rekurs, por çështjet nuk kanë përfunduar ende në Gjykatën e Lartë.

21. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se për sa kohë proceset gjyqësore nuk kanë përfunduar të gjitha shkallët e gjykimit të zakonshëm, në vështirësi në nenit 131/f të Kushtetutës vendimet e kundërshtuara nuk mund të konsiderohen përfundimtare për efektet e gjykimit kushtetues. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk legjitimohen për kundërshtimin e tyre në aspektin kushtetues.

22. Po ashtu, Gjykata, bazuar në qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese se individit mund t'i drejtohet juridiksionit kushtetues kur ka pretendime për mosrespektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe jo për kundërshtimin në mënyrë të drejtpërdrejtë të akteve normative abstrakte, ajo vlerëson se kërkuesit nuk legjitimohen as për sa u takon kërkimeve për shfuqizimin e nenit 16 të ligjit nr. 9719, datë 23.4.2007, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”; aktit normativ nr. 3, datë 1.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”; ligjit nr. 82/2012, datë 13.9.2012, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”.

23. Edhe për sa i takon kërkimit për shpërblimin e dëmit jashtëkontrator material dhe moral, si dhe fitimit të munguar të shkaktuar nga veprimet antikushtetuese të administratës shtetërore, Gjykata, bazuar në qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese, vlerëson se pretendime të kësaj natyre i takojnë juridiksionit të gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë kërkuesit nuk legjitimohen.

24. Gjykata vlerëson gjithashtu se kërkuesit nuk legjitimohen për sa u takon kërkimeve në

lidhje me detyrimin e Gjykatës Kushtetuese për ekzekutimin e vendimit të saj nr. 76/2000; detyrimin e shtetit shqiptar që nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese të privatizojë banesë falas për kërkuesit; arkivimin e një kopjeje të procesit në dosjet personale të funksionarëve që kanë shkaktuar paligjshmërinë; garantimin e jetës së kërkuesve nga dhunuesit, persekutuesit dhe shpërdoruesit e pushtetit; botimin në gazeta të një kopjeje të praktikës. Këto pretendime në vlerësimin e Gjykatës nuk i takojnë sferës së çështjeve që shqyrtohen nga juridiksioni kushtetues.

25. Në vështirësi të sa më sipër, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim vetëm pretendimet e kërkuesve që lidhen me procesin civil me objekt “Lirim dhe dorëzim banese”, të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

26. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë në të gjitha shkallët e gjykimit të çështjes me objekt “Lirim dhe dorëzim banese”.

27. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 25, datë 11.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjyqësor, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e



jashtme mund të ketë rëndësi (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë rëndësi. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen “Driça kundër Shqipërisë”, nr. 33771/02, datë 13.11.2007, §76*).

30. Në jurisprudencën kushtetuese mbi-zotëron qëndrimi se gjykatat e zakonshme duhet të tregohen të kujdesshme lidhur me çështjen e përbërjes së trupit gjykues. Paragjykimi eventual për paanshinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në dyshimin se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimin nr. 12, datë 13.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruara nga kërkuesit për të provuar cenimin e parimit të paanshmërisë gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kanë të bëjnë me mospasqyrimin drejt të fakteve në lidhje me origjinën e kufijtë e pronës, si dhe hetimin e çështjes në mënyrë të njëanshme. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se kërkuesit nuk kanë arritur të ngrenë në nivel kushtetues pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë, pasi argumentet e parashtruara prej tyre kanë të bëjnë me pranimin, çmuarjen dhe vlerësimin e provave, si atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, i cili nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi është i pabazuar.

32. Po ashtu, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë edhe gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, me argumentin se gjyqtari A.B., edhe pse hoqi dorë nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, përsëri ka marrë pjesë në

shqyrtimin e rekursit në Gjykatën e Lartë dhe ka vendosur mospranimin e tij në dhomën e këshillimit.

33. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, Gjykata vëren se në seancën gjyqësore të datës 13.9.2011 të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë kërkuesit kanë kërkuar përjashtimin e gjyqtarit A.B. nga gjykimi i çështjes, pasi me vendimin nr. 2471, datë 19.3.2008, ai ka vendosur kthimin e kërkesëpadisë bashkë me aktet bashkëngjitur, duke e konsideruar këtë padi sikur nuk është paraqitur më parë në gjykatë (*f. 60 e fashikullit gjyqësor të Gjykatës së Apelit*).

34. Gjykata konstaton se edhe vetë gjyqtari A.B. ka deklaruar se “*sa pretendoi kjo palë është e vërtetë. Unë kam gjykuar një çështje kur kam qenë në shkallë të parë me këto palë dhe në këto kushte jap dorëheqjen nga ky gjykim, duke i paraqitur kërkesën time Kryetarit të Gjykatës*”. Kërkesa e gjyqtarit A.B. nuk është pranuar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit, i cili, me vendimin e datës 19.9.2011, bazuar në nenin 73 të KPC-së, ka konstatuar se “*shkaqet që paraqiten për heqje dorë nga gjykimi nuk janë të ligjshme, pasi të paditurit kanë kërkuar me kërkesë me shkrim përjashtimin nga trupi gjykues...Gjykata është e detyruar që ta shqyrtojë kërkesën në përputhje me nenet 74 dhe 75 të KPC-së*”.

35. Në seancën e datës 29.9.2011, kërkuesit e kanë ripërsëritur kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit A.B. dhe kanë kërkuar që trupi gjykues të shprehej për të. Pala paditëse ka deklaruar se nuk ishte dakord me kërkesën e përjashtimit, pasi nuk kishte shkaqe ligjore. Trupi gjykues ka vendosur pranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit A.B. dhe ka shtyrë seancën për të kërkuar plotësimin e trupit gjykues.

36. Gjykata vëren se gjyqtari A.B. gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka marrë në shqyrtim, në dhomë këshillimi, rekursin e paraqitur nga kërkuesi, duke vendosur mospranimin e tij.

37. Në vështrim të rrethanave të mësipërme, Gjykata çmon se dorëheqja e gjyqtarit A.B. dhe vendimmarrja e trupit gjykues për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit janë fakte të cilat justifikojnë dyshimin e kërkuesve. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se ky dyshim është i bazuar nga pikëpamja objektive, për sa kohë gjyqtari A.B. si pjesë e Kolegjit Civil ka shqyrtuar pretendime që lidheshin me parregullsinë e procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit ku vetë



më parë ishte dorëhequr dhe përjashtuar. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se dyshimi i kërkuesve mund të konsiderohet mjaftueshëm i bazuar për të vënë në diskutim vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga këndvështrimi i respektimit të standardeve kushtetuese.

38. Në përfundim Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e njërit prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e kërkuesve, është i bazuar dhe duhet pranuar.

39. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesve, që kanë të bëjnë me cenimin e sigurisë juridike, të së drejtës së pronësisë, të parimit të barazisë së armëve dhe mosarsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata vlerëson të mos i analizojë ato, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g”, dhe 133, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 - Shfuqizimin e vendimit nr. 1736, datë 4.7.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate.
 - Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Skënder Roqi etj., jam kundër qëndrimin të shumicës për pranimin e pretendimit të kërkuesve për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi vlerësoj se ky pretendim është i pabazuar dhe se kërkesa duhet të ishte rrëzuar në tërësinë e saj. Në mbështetje të këtij qëndrimi në vijim paraqes argumentet e mia si gjyqtare në pakicë.

2. Gjykata ka theksuar se në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i parimit të paanshmërisë në gjykim duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta, kurse për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë.

3. Gjykata ka vlerësuar se fakti i pjesëmarrjes së të njëjtit gjyqtar në dy gjykime të iniciuara nga kërkuesi nuk sjell *a priori* cenimin e parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të iniciojë të njëjtën gjykatë dhe të njëjtët gjyqtarë për çështje të ndryshme, por i ndryshëm është qëndrimi kur i njëjti gjyqtar ose gjykatë gjykon të njëjtën çështje gjyqësore (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 29.4.2010*).

4. Në rastin konkret gjyqtari i pretenduar si i njëanshëm nuk ka shprehur qëndrimin e tij në një gjykim të mëparshëm të së njëjtës çështje, me të njëjtin objekt dhe të njëjtat palë. Në kushtet kur ky gjyqtar ka dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes, ai nuk ka mbajtur asnjë qëndrim në lidhjen me zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes palëve. Po ashtu, fakti se ky gjyqtar ka dhënë dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje në gjykatën e apelit, nuk ka asnjë rëndësi në këndvështrim të standardeve të mësipërme. Ky fakt nuk mund të interpretohet për njëanshmëri subjektive të gjyqtarit, për sa kohë që kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë provë tjetër për të



provuar këtë pretendim. Për më tepër, përjashtimi i këtij gjyqtari në apel është kërkuar nga pala tjetër dhe jo nga kërkuuesit, të cilët nuk kanë ngritur më parë asnjë pretendim që ka të bëjë me paanshmërinë e gjyqtarit A.B. Pra, kërkuuesit nuk kanë shteruar mjetet e ankimit për sa i takon këtij pretendimi.

5. Megjithatë, edhe nëse do të shkojmë më tej, bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë procedurat e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, në dhomën e këshillimit verifikohet vetëm legjitimiteti i kërkuuesit, bazueshmëria në ligj e rekursit, si dhe prania e kriterëve ligjore për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa në shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore shqyrtohet bazueshmëria e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, pra themeli i çështjes. Edhe në këtë kuptim vlerësimet e bëra nga gjyqtari në dhomën e këshillimit i referohen vetëm plotësimit të kriterëve ligjore dhe jo themelit të pretendimeve të ngritura nga palët.

6. Shumica nuk ka arritur të argumentojë se cilat janë ato vlerësime të gjyqtarit të cilat shprehin qëndrimin e tij në lidhje me zgjidhjen e çështjes në fjalë dhe që e bëjnë atë të duket i njëanshëm në sytë e palëve në gjykim. Argumenti i shumicës se “dyshimi i kërkuësve është i bazuar nga pikëpamja objektive, për sa kohë gjyqtari A.B. si pjesë e Kolegjit Civil ka shqyrtuar pretendime që lidheshin me parregullsinë e procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit ku vetë më parë ishte dorëhequr dhe përjashtuar” (*shih paragrafin 37 të vendimit*), është i pamjaftueshëm për të justifikuar pranimin e këtij pretendimi, ndërkohë që ajo nuk ka arritur të argumentojë mjaftueshëm se cilat janë ato veprime e sjellje konkrete të gjyqtarit që vënë në dyshim paanshmërinë e tij në gjykimin në fjalë.

7. Për argumentet e parashtruara më sipër vlerësoj se kërkesa është e pabazuar dhe se ajo duhej të ishte rrëzuar nga Gjykata.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë